



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.30.1-2012-08

RAPORTI FINAL I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT
RREGULLATIV TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Maj 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për qdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Hysen Boqolli (Udhëheqës i ekipit) dhe Alban Beka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
5 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	18
6 Konkluzioni i përgjithshëm	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për ish-Autoritetin Rregullativ i Telekomunikacionit ART-së tani e tutje me ligjin e ri nr. 04/L-109 për komunikime elektronike quhet Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) pasardhëse e ART-së. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyra Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij, në formatin e përcaktuar në Shtojcën I që shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP-it. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë (SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive. ARKEP ka dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm për të gjithat fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për të verifikuar efektshmërinë e sistemit aktual, ARKEP ka kontraktuar një kompani çertifikuese

ndërkombëtare, e cila e ka çertifikuar sistemin e menaxhimit të cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit EN ISO 9001:2008 dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative të aplikueshme.

Testimet tona kanë vënë në pah që këto procese dhe procedura kanë siguruar që menaxhimi financiar dhe kontrolli në ARKEP kryhet në pajtim me legjislacionin në fuqi, me disa përjashtime të ndërlidhura me menaxhimin e procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të pasurisë. Këto mangësi janë të shpjeguara më në detaje më poshtë.

Sistemi i informacionit ka siguruar që proceset dhe procedurat aktuale ofrojnë informata të sakta për prodhimin e PVF-ve. ARKEP ka përgatitur planin për implementimin e rekomandimeve të dhëna vitin e kaluar dhe ka treguar përkushtim në adresimin e tyre.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin ARKEP në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të ARKEP-it dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Pasqyra Vjetore Financiare

- Menaxhmenti duhet të sigurojë që plani i prodhimit për llogaritë 2013 përfshin rishikimin menaxherial të draft llogarisë.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Në bashkëpunim me akterët e tjerë, të përcaktoj dhe harmonizoj prioritetet për realizim të projekteve kapitale për të cilat paraprakishtë është konfirmuar mbështetja dhe të cilat kanë mundësi më të madhe të implementohen;
- Menaxheri i prokurimit duhet të sigurojë që zyrtarët e caktuar në komisionet e vlerësimit kanë njohurit e duhura. Më tutje, menaxheri i prokurimit përmes monitorimit duhet të sigurojë që ekzistojnë dëshmit të cilat mbështesin vlerësimet e ofertave nga komisioni i vlerësimit; dhe
- Në koordinim më departamentin e thesarit ka shqyrtuar alternativat e duhura për të siguruar vlerësimin e pasurive të cilat tashmë e kanë vlerën neto zero, por që edhe me tutje janë në përdorim dhe kanë një vlerë tregu.

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturën tonë të auditimit dhe është zotuar se do ta adresojë rekomandimin.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e ARKEP-së të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për ARKEP. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj të gjeturave tona mund të gjenden në Shtojcën III. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i draft pasqyrave vjetore financiare të dërguara në fund të Janarit 2013 merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtarit Kryesor Administriv (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". ARKEP ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim.

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të muajit dhjetor 2012 janë adresuar nga Menaxhmenti.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Informatat e prezantuara në Pasqyrat vjetore financiare janë të cilësisë së mirë dhe janë dhënë shpalosje të mjaftueshme.

Përshkrimi

Si rezultat i rishikimeve tona analitike të draft PVF-2012, ne kemi këshilluar ARKEP-in për korrigjimin e draft pasqyrave financiare. Këshillat tona kishin të bëjnë me korrigjimet në vijim:

- Shënimin 16 grantet nuk është dashur të paraqitet asnjë vlerë për arsye se nuk i takojn vitit 2012; dhe
- Kolona F hyrjet për vitin 2010 nuk kishte paraqitur donacionin e realizuar në vlerë 50,000€.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të janë dorëzuar në Qeveri mund të konsiderohen si jo plotësisht të vërteta.

Megjithatë, ARKEP ka ndërmarr masat adekuata dhe ka korigjuar mangësit e identifikuar lidhur me saktësinë dhe cilësinë e informatave të prezantuara në PVF 2012.

Rekomandimi

1. Çështja - Procesi i prodhimit të llogarive - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura	Pasqyrat vjetore financiare dhe letrat shoqëruese të punës ishin subjekt i rishikimit të menaxhmentit para se ato të prezantohen në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Edhe përkundër këtij rishikimi, draft PVF kanë rezultuar në një numër të vogël gabimesh, të cilat mund të ishin evituar nga Rishikimi i Menaxhmentit.
Rreziku	Draft Pasqyrat vjetore financiare përmbanin gabime dhe nëse korrigjimet e duhura nuk do të ishin kryer, atëherë mund të ekzistonte edhe rreziku për theksim të çështjes në opinion të auditimit.
Rekomandimi 1	Menaxhmenti duhet të sigurojë që plani i prodhimit për llogaritë 2013 përfshin rishikimin menaxherial të draft llogarisë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje *të drejtë dhe të vërtetë* (SNISA 400 **Opinion i Pakualifikuar**).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

ARKEP ka përgatitur planin për implementimin e rekomandimeve të dhëna vitin e kaluar dhe ka treguar përkushtim në adresimin e tyre. Ky përkushtim ka ndikuar që ARKEP të eliminoj disa mangësi të vitit të kaluar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2011 të ARKEP ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime kryesore. ARKEP ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar mënyrën për adresimin e rekomandimeve.

ARKEP ka adresuar plotësisht dy (2) rekomandime, një (1) rekomandim është adresuar plotësisht vetëm për pjesën e testuar dhe tri (3) rekomandime janë adresuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak-Prioriteti- i rëndësishëm

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar plotësisht, përderisa tri të tjera ishin në proces.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontroleve të brendshme në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë rezultuar në:

- Mangësit në menaxhimin e prokurimit dhe menaxhimin e pasurisë.

Rekomandimi 2 Menaxhmenti duhet të siguroj që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve tona është rishikuar së bashku me pjesëmarrësit në zingjirin llogaridhënes me qëllim të përcaktimit të veprimeve korigjuese.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Proceset dhe linjat e llogaridhënies në ARKEP kanë funksionuar si duhet, në përjashtim të çështjeve të prezantuara më poshtë në fushën e prokurimit dhe të pasurive.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Realizimi i buxhetit në masë prej 82% është tregues që planifikimi dhe realizimi i buxhetit në ARKEP ka vend për përmirësim, me theks të veçant planifikimi dhe realizimi i projekteve kapitale.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për ARKEP ish-ART, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,169,474	769,381	632,279	804,488	772,158
Granti i Qeverisë-Buxheti	1,169,474	759,474	632,279	28,708	34,250
Të hyrat vetanake				735,675	737,908
Donacionet e Jashtme		9,907		40,104	

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 1, tregon se ARKEP për vitin 2012 kishte shpenzuar 632,279€ apo 82% të buxhetit final. Buxheti i final krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për vlerën 400,093€, për më detaje shih informatat poshtë tabelës nr.2.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,169,474	769,381	632,279	804,488	772,158
Pagat dhe Mëditjet	266,488	266,488	266,487	295,196	246,090
Mallrat dhe Shërbimet	387,986	310,986	251,088	319,193	388,762
Komunalitë	15,000	15,000	11,034	10,332	10,647
Investimet Kapitale	500,000	176,907	103,670	179,826	126,658

Buxheti fillestar në krahasim më atë final ka pësuar ndryshimet në vijim:

- Me buxhetin e rishikuar janë tërhequr tri projekte tjera kapitale dhe në të njëjtën kohë janë shtuar tri tjera. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti për kategorinë e investimeve kapitale me rishikim ishte zvogëluar për 183,000€. Në buxhetin final është përfshir edhe donacioni norvegjez për projektin e KOSIX-it (nyjës shkëmbyese të internetit) në vlerë 9,907€. Ky donacion nuk është shpenzuar në vitin 2012.
- Më 14.11.2012, ARKEP ka deklaruar kursime në vlerë 77,000€ në kategorinë mallra dhe shërbime, dhe
- Në kategorinë investime kapitale ka deklaruar të lira 150,000€ të planifikuara për projektin “Zhvillimi dhe ngritja e platformës për regjistrimin dhe identifikimin e pajisjeve telekomunikuese”.

Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Te hyrat vetjake	4,550,000	4,550,000	5,749,363	18,043,503	9,608,554

3. Çështja - Çështja 2 - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Prioriteti-i rëndësishëm

- E gjetura** ARKEP në planifikimin e buxhetit fillestar kishte paraparë katër(4) projekte për investimet kapitale. Më pas, kishte tërhequr projektet e planifikuara në fillim të vitit dhe kishte vendosur në plan realizimin e tri projekteve tjera kapitale. Sipas ARKEP-it, ndryshimi i projekteve kapitale ka ndodhur si pasojë e faktorëve të jashtëm²
- Rreziku** Ndikimi i faktorëve të tjerë kryesisht të karakterit të jashtëm dhe mungesa e qartësisë ligjore dhe koordinimit ndërinstitucional, kanë ndikuar që projektet kapitale të ndryshohen në mes të vitit. Kjo mund të ketë për pasojë mos arritjen e objektivave të ARKEP-it më kohë.
- Rekomandimi 3** Në bashkëpunim me akterët e tjerë, të përcaktoj dhe harmonizoj prioritetet për realizim të projekteve kapitale për të cilat paraprakishtë është konfirmuar mbështetje dhe të cilat kanë mundësi më të madhe të implementohen.

4.3 Kerkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Kërkesat për raportim të jashtëm ARKEP i ka përmbushur, në nivel të knaqshëm.

Përshkrim

ARKEP ka përmbushur kërkesat për raportim dhe atë si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportin Vjetor të performancës së ART-së për vitin 2011;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

² Mos sigurimin e kodit telefonik, mos jetësimin e veprimeve nga planet veprimeve të strategjive sektoriale e shtetërore ku nderlidhen edhe dinamika e jetesimit të veprimeve/projekteve si dhe vonesa në aprovimin e ligjit dhe përfshirjes së amandamenteve të Autoritetit.

4.4 Të hyrat vetanake

Konkluzion i përgjithshëm

ARKEP ka arritur që të inkasoj të hyra më shumë se vlera e buxhetuar në fillim të vitit 2012. Inkasimi i të hyrave vetanake për mostrat e testuara ishte realizuar në pajtim me procedurat dhe rregullat e aplikueshme.

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga ARKEP për vitin 2012 ishin në vlerë 5,749,363€. Këto kanë pasur të bëjnë kryesisht me: Autorizimet/Licencimet, Akordimin dhe dhënien në shfrytëzim të resurseve të numeracionit, Akordimin dhe dhënien në shfrytëzim të së drejtës për resurse të spektrit frekuencor dhe me shqiptimin e masave sanksionuese/ndëshkimeve. Testimet tona kanë përfshirë një mostër prej 47 transaksioneve në vlerë prej 3,932,863€. Ne nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi për tu raportuar.

Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm

Shpenzimet e realizuara janë proceduar në nivel të mirë përveq disa mangësive në prokurim dhe regjistrim të pagesave të paraqitura në nënkapitujt në vijim.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Gjatë punës sonë të auditimit ne kemi testuar 11 procedura të prokurimit dhe 27 pagesa nga lista e pagesave në vlerë prej 163,237€.

4. Çështja - Mangësi në procesin e prokurimit -Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Në tri aktivitetet e prokurimit në vijim, komisioni i vlerësimit i kishte vlerësuar operatorët ekonomik të përgjegjshëm për kundër mos plotësimit të kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit :
- Për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pije jo alkoolike” me procedurë kuotim çmimi, në dosje të tenderit Operatorëve Ekonomik (OE) u mungonte vërtetimin e lëshuar nga ATK-ja për pagesën e tatimit. ;
 - Në dosjen e tenderit për “Shërbime të pastrimit të hapësirave të ART-së” mungonte fatura e KEK-ut nga OE fitues i tenderit; dhe
 - Në dosjen e tenderit “Furnizimi me pjesë rezervë RFDU, për stacionin mobil monitorues MMS-TADIRAN” me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontrat, në vlerë prej 34,858€, mungonin dy kontrata të ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit nga OE, kriter ky i kërkuar me dosje të tenderit.
- Rreziku** Dështimi në vlerësimin e ofertave sipas kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit rrezikon në mostrajtim të barabartë të ofertuesve. Më tutje, mangësit e cekura më lartë mund të jenë rezultat i njohurive të pamjaftueshme të zyrtarëve të caktuar në komisione të vlerësimit.
- Rekomandimi 4** Menaxheri i prokurimit duhet të siguroj që zyrtarët e caktuar në komisionet e vlerësimit kanë njohurit e duhura. Më tutje, menaxheri i prokurimit përmes monitorimit duhet të siguroj që ekzistojnë dëshmit të cilat mbështesin vlerësimet e ofertave nga komisioni i vlerësimit.

5. Çështja - Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike të gabuara- Prioriteti-Të tjera

- E gjetura** Shpenzimet për furnizim për orendi për zyre në vlerë 2,050€ janë regjistruar në kodin ekonomik 13509 (Pajisje tjera) ndersa është dashur të regjistrohen në kodin ekonomik 13501 (Mobilje nen 1000€). Më tutje, pagesa në vlerë 9,760€ për furnizim dhe instalim i pajisjeve të mbrojtjes së objektit të ART-së (Kamera, alarm dhe shuarje automatike të zjarrit), janë regjistruar në kodin ekonomik 13460 (shpenzimet tjera kontraktuese), ndërsa është dashur të regjistrohen në kodin ekonomik 13509 (Pajisje tjera me pak se 1,000€).
- Rreziku** Mosregjistrimi në kode ekonomike adekuate shkakton që institucione të mos këtë një pamje reale të shpenzimeve për zëra të caktuar të shpenzimeve.
- Rekomandimi 5** Të bëhet regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike duke u bazuar në planin kontabël qeveritar.

4.5.2 Shpenzimet tjera

Përshkrim

Ne kemi testuar gjashtë (6) pagesa në vlerë 19,504€ nga blerjet të cilat nuk shkojnë përmes procedurave të prokurimit. Testimet tona nuk kanë hasur në ndonjë mangësi të këtyre shpenzimeve.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Buxheti për këtë kategori ekonomike ishte 266,488€, ndërsa ishin shpenzuar 266,487€. ARKEP me buxhet kishte të punësuar aq sa ishte i lejuar më buxhet, 33 punonjës.

Zyra e personelit udhëhiqej nga zyrtari ligjor. Gjatë kësaj faze të auditimit kemi testuar 5 mostra, për të siguruar së stafi i angazhuar merr shpërblimin në paga sipas kontratave dhe që dosjet janë complete. Testimet tona nuk kanë hasur në ndonjë parregullsi materiale për tu raportuar.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhimi i pasurive në ARKEP ka nevojë të forcohet veçanarisht në vlerësimin dhe regjistrimin e tyre, më qëllim që të shprehet një pamje më e saktë e pasurive.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Në nenin 16 të PVF-ve 2012, ARKEP ka shpalosur vlerën e pasurive mbi 1,000€ në vlerë neto 1,340,066€, për ato nën 1,000€ në vlerë 42,537€ dhe stoqe në vlerë 6,154€.

6. Çështja - Mos vlerësimi i pasurive me vlerë të mbetur zero-Prioriteti - Të tjera

E gjetura	ARKEP kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurive, por akoma nuk kishte bërë vlerësimin e pasurive me vlerë të mbetur (neto) zero.
Rreziku	Mosvlerësimi i pasurive të cilat kanë vlerën e bartur zero mund të rezultoj që institucioni të mos ketë njohuri për vlerën reale të pasurive në dispozicion.
Rekomandimi 6	Në koordinim me departamentin e thesarit ka shqyrtuar alternativat e duhura për të siguruar vlerësimin e pasurive të cilat tashme e kanë vlerën neto zero, por që edhe me tutje janë në përdorim dhe kanë një vlerë tregu.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm

Bashkëpunimi me departamentin e auditimit të brendshëm të Ministrisë së Financave (MF) tregon përkushtimin e ARKEP-it për vlerësimin e proceseve aktuale me qëllim të menaxhimit më të mirë të financave publike.

Përshkrimi

Bazuar në udhëzimin administrativ nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm të sektorit publik ARKEP i plotëson kriteret për të themeluar NJAB. Ne kemi vërejtur se, ARKEP në mungesë të buxhetit dhe pozitave të aprovuara nuk kishte arritur të themeloj këtë njësi.

Këtë shërbim e kishte kryer departamenti i auditimit të brendshëm në MF. Ky departament ka realizuar një auditim të rregullsisë me fushëveprim vitin 2011 deri në qershor 2012 me objektiv "Funksionimi i ART". AB ka dhënë katër(4) rekomandime për përmirësim. ARKEP ishte në proces të implemetimit të këtyre rekomandimeve. Gadishmëria e ARKEP-së për plotësimin e rekomandimeve tregon vullnetin që ka institucioni për përmirësimin e qeverisjes.

Rekomandimet

7. Çështja - Themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm -Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Bazuar në udhëzimin administrativ nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm të sektorit publik ARKEP i plotëson kriteret për të themeluar NJAB. ARKEP nuk kishte themeluar këtë njësi.

Rreziku Meqenëse, ARKEP plotëson kriteret për NJAB dhe duke marrë parasysh kompleksitetin e aktiviteteve lidhur me komunikimet elektronike dhe postare, nevoja për vlerësimin e efektshmërisë së proceseve është e rëndësishme.

Rekomandimi 7 Të vazhdohet me adresimin e çështjes se themelimit të NJAB-së tek autoritetet përkatëse në Kuvend për të siguruar që aktivitetet e ARKEP-it vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Në shumicën e fushave ARKEP ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat sigurojnë bazë për të siguruar përdorim efektiv të parasë publike dhe/ose dhënien e informatave të cilësisë së mirë, të cilat mbështesin vendimmarrjet e menaxhmentit.

Për të gjitha fushat e menaxhimit të financave, ne kemi qenë në gjendje që të marrim siguri të arsyeshme për funksionimin e kontrolleve të brendshme. Aktivitetet e kontrollit dhe monitorimit në fushën e prokurimit, pagesave dhe pasurive kanë ende vend për përmirësim.

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". ARKEP ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim.

ARKEP duhet të shtoj bashkëpunimin me akterët e tjerë për të siguruar që janë planifikuar projekte kapitale të cilat kanë mundësi të realizohen. Kjo do të duhej të tërhiqte vëmendjen e menaxhmentit me qëllim që objektivat e ARKEP-it të realizohen.

Rritja e kontrolleve në fushat e identifikuara me mangësi do të ndihmonte ARKEP-në në sigurimin e menaxhimit efektiv të financave publike.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhena	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
6.1 Te hyrat	Autorizimet e licencave janë konsistente.	PO		
6.2.1 Kompensimet (Pagat dhe Meditjet)	Aktemerimet e punonjëseve permbajnë nivelin e pagës si element kyq i mardhenies kontraktuale.	PO		
6.2.2 Prokurimi	Softveri i TI-së trajtohet si projekt i investimeve kapitale dhe paguhet nga kategoria ekonomike adekuate; Plani final i prokurimit të jetë në përputhje me projektet e aprovuara në buxhet; Janë shtuar kontrole rreth menaxhimit të kontratave dhe Janë ndermarrë masa për funksionalizimin e plotë të WEB-GIS-it më qellim të arritjes së kërkesave/objektivave të parapara.	PO, për tri pikat e para ndërsa funksionalizimin e plotë të WEB-GIS-it nuk e kemi testuar meqenëse ishte nën hetime.		

6.3.1 Trajtimi i pasurive kapitale dhe jokapitale	Në koordinim më departamentin e thesarit ka shqyrtuar alternativat e duhura për të siguruar vlerësimin e pasurive të cilat tashme e kanë vlerën neto zero, por që edhe me tutje janë në përdorim dhe kanë një vlerë tregu; dhe Pasuritë e regjistruara në sistemin E-pasuria, të përmirësohen në menyrë që të prezenton gjendjen reale të pasurisë.		Pjesërisht.	
7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm	Qështja e shërbimeve të auditimit të brendshëm është diskutuar më komisionet relevante në Kuvendin e Kosovës.		Pjesërisht.	
8 Konkluzion i përgjithshëm për kryetarin e bordit të ART-së	Mangesit e identifikuar në proceset e prokurimit janë analizuar dhe masat përmirësuese janë ndermarr më qëllim të forcimit të metejme të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.		Pjesërisht.	